



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

RELACION
PËR PROJEKTVENDIMIN

PËR

**KONSTATIMIN E KUSHTEVE TË MOS MARRJES SË MANDATIT PËR
USHTRIMIN E FUNKSIONIT TË ANËTARIT NË KËSHILLIN E BASHKISË
FIER, TË KANDIDATIT NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË
DEMOKRACIA SOCIALE, ZJ. XHULIA AGIM OSHAFI (DERVISHI)**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Me shkresën nr. 3482 prot., datë 09.05.2022, këshilli i bashkisë Fier, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Oljana Jashar Bushaj, propozuar nga Partia Demokracia Sociale.

Në bazë të nenit 164, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Demokracia Sociale, për këshillin e bashkisë Fier, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 04, zj. Xhulia Agim Oshafi.

Me shkresën nr. 2478, prot., datë 26.05.2022, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në këshillin e bashkisë Fier, zj. Xhulia Agim Oshafi, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.



Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit Partia Demokratia Sociale, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 32 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Xhulia Agim Oshafi, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Por, gjatë verifikimit të të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit zj. Xhulia Agim Oshafi, rezultoi se vendbanimi i saj nuk ishte “Fier”, por Tiranë.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, me shkresën nr. 1791 prot., datë 28.06.2022 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 1792 prot., datë 29.06.2022 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për zj. Xhulia Agim Oshafi.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr.6840/1 prot.,datë 05.07.2022, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për zj. Xhulia Agim Oshafi, ku konstatohet se me lidhjen e martesës ka marrë mbiemrin e bashkëshortit duke ndryshuar përbërësit e gjendjes civile nga “Oshafi” në “Dervishi”.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 7844/1 prot., datë 01.07.2022, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për Xhulia Agim Oshafi, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Me shkresën nr. 4883 prot., datë 06.06.2022, këshilli i bashkisë Fier, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me gjendjen civile të zj. Xhulia Agim Oshafi. Nga verifikimi i Regjistrit Kombëtar të Shtetasve të vitit 2010, rezultoi se kandidati për anëtar në këshillin e bashkisë Fier, zj. Xhulia Agim Oshafi (Dervishi) është shpërngulur në njësinë Administrative Kashar, Tiranë.

Ndodhur në këto kushte, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2687, prot., datë 13.06.2022 i është drejtuar kandidatit për anëtar në këshillin e bashkisë Fier, zj. Xhulia

Agim Oshafi, në kuadër të verifikimit të mëtejshëm, vënien në dispozicion të çertifikatës personale.

Me shkresën e protokolluar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 2687/1 prot., datë 16.06.2022, zj. Xhulia Agim Dervishi ka depozituar çertifikatën personale, ku konstatohet se vendbanimi i saj është “Rruga Artan Minarolli, nd. 34, H. 1, Kashar, Mëzez, Tiranë”.

Në mbështetje nenit 109 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenit 49, pika 4, shkronja “a”, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të drejtën e zgjedhjes në këshillat vendore e kanë vetëm shtetasit që janë me banim të përhershëm në territorin e njësisë vendore përkatëse. Konstatohet se në momentin e verifikimit të formularit të vetëdeklarimit nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rezultoi se kandidati për anëtar zj. Xhulia Agim Oshafi (Dervishi), nuk e ka vendbanimin në njësinë vendore ku ajo kandidon, gjë e cila do të përbënte kusht për mos marrjen e mandatit të funksionit të këshilltarit.

Madalena KOJA - Drejtorja Juridike dhe e Dokumentacionit Zgjedhor

Aurel LAMÇE - Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore,
Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse

Ylli MERKAJ - Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: Shtator 2022

Nr:

PROJEKTVEKNDIM

PËR

**KONSTATIMIN E KUSHTEVE TË MOS MARRJES SË MANDATIT PËR USHTRIMIN
E FUNKSIONIT TË ANËTARIT NË KËSHILLIN E BASHKISË FIER, TË
KANDIDATIT NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË DEMOKRACIA SOCIALE,
ZJ. XHULIA AGIM OSHAFI (DERVISHI)**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, nenit 49, pika 4, shkronja “a”, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 3482 prot., datë 09.05.2022, këshilli i bashkisë Fier, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Oljana Jashar Bushaj, propozuar nga Partia Demokracia Sociale.



Data: Shtator 2022

Nr.

Konstatimin e kushteve të mos marrjes së mandatit për ushtrimin e funksionit të anëtarit në këshillin e bashkisë Fier, të kandidatit nga lista shumëmemërore e Partisë Demokracia Sociale, zj. Xhulia Agim Oshafi (Dervishi)

Në bazë të nenit 164, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Demokratice Sociale, për këshillin e bashkisë Fier, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 04, zj. Xhulia Agim Oshafi.

Me shkresën nr. 2478, prot., datë 26.05.2022, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në këshillin e bashkisë Fier, zj. Xhulia Agim Oshafi, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit Partia Demokratice Sociale, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 32 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Xhulia Agim Oshafi, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Por, gjatë verifikimit të të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit zj. Xhulia Agim Oshafi, rezultoi se vendbanimi i saj nuk ishte “Fier”, por Tiranë.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, me shkresën nr. 1791 prot., datë 28.06.2022 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 1792 prot., datë 29.06.2022 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për zj. Xhulia Agim Oshafi.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr.6840/1 prot., datë 05.07.2022, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për zj. Xhulia Agim Oshafi, ku konstatohet se me lidhjen e martesës ka marrë mbiemrin e bashkëshortit duke ndryshuar përbërësit e gjendjes civile nga “Oshafi” në “Dervishi”.



Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 7844/1 prot., datë 01.07.2022, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për Xhulia Agim Oshafi, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Me shkresën nr. 4883 prot., datë 06.06.2022, këshilli i bashkisë Fier, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me gjendjen civile të zj. Xhulia Agim Oshafi. Nga verifikimi i Regjistrimit Kombëtar të Shtetasve të vitit 2010, rezultoi se kandidati për anëtar në këshillin e bashkisë Fier, zj. Xhulia Agim Oshafi (Dervishi) është shpërngulur në njësinë Administrative Kashar, Tiranë.

Ndodhur në këto kushte, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2687, prot., datë 13.06.2022 i është drejtuar kandidatit për anëtar në këshillin e bashkisë Fier, zj. Xhulia Agim Oshafi, në kuadër të verifikimit të mëtejshëm, vënien në dispozicion të çertifikatës personale.

Me shkresën e protokolluar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 2687/1 prot., datë 16.06.2022, zj. Xhulia Agim Dervishi ka depozituar çertifikatën personale, ku konstatohet se vendbanimi i saj është “Rruga Artan Minarolli, nd. 34, H. 1, Kashar, Mëzez, Tiranë”.

Në mbështetje nenit 109 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenit 49, pika 4, shkronja “a”, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të drejtën e zgjedhjes në këshillat vendore e kanë vetëm shtetasit që janë me banim të përhershëm në territorin e njësisë vendore përkatëse. Konstatohet se në momentin e verifikimit të formularit të vetëdeklarimit nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rezultoi se kandidati për anëtar zj. Xhulia Agim Oshafi (Dervishi), nuk e ka vendbanimin në njësinë vendore ku ajo kandidon, gjë e cila do të përbënte kusht për mos marrjen e mandatit të funksionit të këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë



funksiione publike”, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe nenit 49, pika 4, shkronja “a”, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” dhe nenit 109 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

V E N D O S:

1. Zj. Xhulia Agim Oshafi (Dervishi), kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Fier, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit, të parashikuar nga ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike”.
2. Këshilli i Bashkisë Fier, të verifikojë nëse kandidati për anëtar në këshillin e bashkisë Fier ka vendbanim të përhershëm në territorin e njësisë vendore Fier.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: Shtator 2022

Nr.

Konstatimin e kushteve të mos marrjes së mandatit për ushtrimin e funksionit të anëtarit në këshillin e bashkisë Fier, të kandidatit nga lista shumëmemërore e Partisë Demokratice Sociale, zj. Xhulia Agim Oshafi (Dervishi)